



Prishtinë: 11.11.2010

Kodi i ZRRE-së: V_304_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_472_10_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 14.6 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_472_10_10**;
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2010 nxori këtë:

VENDIM

PRANOHET ankesa e konsumatorit Ymer Shatri nga Prishtina, (shifra e konsumatorit DPR – 90021879), si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të 16.03.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 03.03.2009 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 25.06.2003 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr njehsorin nr. 179146 dhe kanë vendosur njehsorin nr. 3455040.
Provë: Procesi mbi heqjen dhe ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 2 të datës 25.06.2003
- Me datë 27.06.2003 punëtorët e autorizuar të KEK-ut të shërbimit të bazhdarimit kanë bërë shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 179146, ku kanë konstatuar se njehsori elektrik është i pasaktë në çdo ngarkesë, pa saktësia më e theksuar është për ngarkesa të vogla.
Provë: Protokollin mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 45/67 të datë 27.06.2003
- Me datë 25.06.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr njehsorin nr. 34550540 dhe kanë vendosur njehsorin nr. 17691941
Provë: Procesi mbi heqjen dhe ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 0311 të datës 25.06.2007

- Me datë 12.07.2007 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 34550540, ku është konstatuar se njehsori elektrik pa vula (blloba) shtetërore dhe buloni bllobues i mungon, numëruesi i manipuluar.
Provë: Procesverbali nr. 12/12 të datës 12.07.2007
- Me datë 24.07.2008 punëtorët e KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe për të marrë profilin e kabllit furnizues.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 0145135 të datës 24.07.2008
- Me datë 23.08.2008 punëtorët e KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe për të marrë profilin e kabllit furnizues.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 177946 të datës 23.08.2008
- Me datë 23.09.2008 punëtorët e KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe për të marrë profilin e kabllit furnizues.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 182365 të datës 23.09.2008
- Me datë 17.11.2008 punëtorët e KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe për të marrë profilin e kabllit furnizues.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 233865 të datës 17.11.2008
- Me datë 12.12.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike me anë të faturës DPR08HP07129 në vlerë 8,357.83 €.
Provë: Fatura DPR08HP07129 të datës 12.12.2008
- Me datë 23.02.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 03.03.2009 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe të kalibrimit.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 03.03.2009
- Me datë 16.03.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 08.12.2009 DMK në pajtim me paragrafin 14.3 të nenit 14 të Rregullit mbi Procedurën për Zgjidhjen e Kontesteve në Sektorin e Energjisë, ka analizuar ankesat e konsumatorëve dhe ka vlerësuar se zyrtarët e autorizuar për inspektimin e pikave matëse gjatë përpilimit të procesverbaleve nuk kanë shënuar shumat e fuqive të shpenzuesve të inventarizuara me rastin e inspektimit të pikave matëse tek konsumatorët komercial dhe industrial ka kthyer në rishqyrtim lëndën e konsumatorit. Sipas kësaj KEK-u ka vepruar në kundërshtim me Nenin 12 të Procedurës së Përkohshme për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar.
Provë: Shkresa e DMK-së dërguar KEK-ut (Departamentit për Konsumator) për rishqyrtimin e ankesave të konsumatorëve
- Me datë 21.05.2010 Komisioni i KEK-ut në përbërje të stafit përgjegjës të operatorit të rrjetit dhe furnizuesit publik, ka pranuar pjesërisht ankesën e konsumatorit.
Provë: Vendimi i Komisionit të KEK-ut të datës 21.05.2010

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për kontrollimin e njehsorëve elektrik në laboratorin e qendrës së kalibrimit kanë konstatuar se njehsori elektrik nr. 34550540, pa vula (bllomba) shtetërore dhe buloni bllombues i mungon, numëruesi i manipuluar, ky konstatim është bërë pa pjesëmarrjen e palës së tretë (përfaqësuesve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë apo përfaqësuesve të institucioneve të pavarura) ashtu siç është përcaktuar në nenin 7 të Procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar.
- ✓ Pasi që DMK e ka dërguar lëndën e konsumatorit në rishqyrtim në KEK, punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me datë 18.01.200 dhe kanë bërë regjistrimin e pajisjeve elektrike.
Provë: Procesverbal i KEK-ut nr. 062253 të datës 18.01.2010
- ✓ KEK-u pasi ka marrë pajisjet elektrike të regjistruara në procesverbalin nr. 062253 të datës 18.01.2010 ka bërë edhe llogaritjen e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Sipas llogaritjeve të bëra nga KEK-u del se konsumatori është dashur të faturohet me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike në vlerë prej 550.40 €.
Provë: Llogaritje e KEK-ut për shfrytëzim të paautorizuar
- ✓ Komisioni i KEK-ut pasi ka marrë lëndën e konsumatorit në rishqyrtim, ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe ka refuzuar ankesën e konsumatorit në arsyetimin se: *“konsumatorit njehsori nr. 34550540 sipas procesverbalit nr. 0311 i është ndërruar me dt. 25.06.2007. Ky njehsor është dërguar në shërbimin e kalibrimit dhe me dt. 12.07.2007 është përgatitur procesverbal i kontrollimit detal nr. 12/12 sipas të cilit: njehsori pa pllomba shtetërore dhe buloni i pllombës i mungon, numëruesi i manipuluar. Në bazë të këtij procesverbal shërbimi i faturimit ka llogaritur faturën interne duke u bazuar në siguresa 32 A. Sipas kësaj edhe me dt. 12.12.2008 ka rezultuar fatura e RH në vlerë 8,357.830 €. Vërejtje: Fatura interne në bazë të cilit llogaritet fatura e RH, sipas Proc. Perk. Për idenë. Dhe paran. Duhet të bazohet në pajisjet të pajisjet të cilat i furnizon pika matëse e jo në siguresa siç është llogaritur RH. Njehsori është prodhim i viti 2003. Shpenzimi mesatar i energjisë që është regjistruar në periudhën e RH është 394 kW, në periudhën para RH është 413 kW dhe pas RH është 519 kW. Rillogaritja e RH me pajisje sipas procesverbalit të kontrollës rezulton me vlerë 550.40 € €. Vendimi i komisionit: Dënimi mbetet dhe të rillogaritet”.*
Provë: Vendimi i Komisionit të KEK-ut të datës 26.01.2010
- ✓ Komisioni i KEK-ut në vendimin e tyre pas rishqyrtimit të lëndës së konsumatorit ka refuzuar ankesën e konsumatorit në arsyetimin se: në bazë të fakteve nga procesverbal nr. 12/12 dt. 12.07.2007 dhe sipas parametrave të paraqitura në procesverbalin nr. 233865 dt. 17.11.2008 konstatojmë se fatura nr. DPR08HP07129 dt. 12.12.2008 në vlerë 8,357.83 € është llogaritur konform nenit 12 të procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Rillogaritja e RH sipas pajisjeve nga procesverbal nr. 062253 dt. 18.01.2010 rezulton në vlerë 1,323.85 €. Por pasi evidentimi i këtyre pajisjeve është bërë në një periudhë tjetër nga periudha e rikthimit të humbjeve, komisioni qëndron pranë vendimit ekzistues.
Provë: Vendimi i Komisionit të KEK-ut të datës 21.05.2010
- ✓ KEK-u edhe përkundër asaj që DMK ka kthyer në rishqyrtim ankesën e konsumatorit dhe i ka konstatuar se KEK nuk ka vepruar sipas nenit 12 të procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, KEK-u

prapë ka refuzuar ankesën e konsumatorit, duke mos e marrë për bazë shkeljen e procedurës.

- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike gjatë sezonës dimërore me njehsor elektrik nr. 34550540 për periudhën 10/2006 – 03/2007 është 382.50 kWh/muaj, për periudhën 10/2005 – 03/2006 është 431.17 kWh/muaj, ndërsa me njehsor elektrik nr. 17691941 për periudhën 10/2007 – 03/2008 është 418.67 kWh/muaj.
Provë: Rrjedha e energjisë aktive
- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike gjatë sezonës verore me njehsor elektrik nr. 34550540 për periudhën 04/2006 – 09/2006 është 517.33 kWh/muaj, për periudhën 04/2005 – 09/2005 është 516.83 kWh/muaj ndërsa me njehsor elektrik nr. 17691941 për periudhën 04/2008 – 09/2008 është 484.00 kWh/muaj.
Provë: Rrjedha e energjisë aktive
- ✓ Sipas analizave të bëra rrjedhës së energjisë aktive vërehet se mesatarja e shpenzimeve sipas sezonave me njehsor të ri nr. 17691941 ka një rritje të vogël në krahasim me njehsorin e vjetër nr. 34550540. Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsor të vjetër nr. 3455040 prej periudhës 08/2003 e deri 06/2007 ka qenë 439.39 kWh/muaj, ndërsa mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsor të ri nr. 17691941 prej periudhës 08/2007 e deri 10/2008 ka qenë 532.00 kWh/muaj. Sipas kësaj analize shihet se mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsor të ri ka një rritje të vogël prej 21 % në krahasim me njehsor të vjetër. **Provë:** Rrjedha e energjisë aktive
- ✓ Sipas rrjedhjes së energjisë aktive të konsumatorit shihet se mesatarja e konsumit të konsumatorit sipas viteve është: 2004 – 422.50 kWh/muaj; 2005 – **470.08** kWh/muaj; 2006 – **469.58** kWh/muaj; 2007 – **380.38** kWh/muaj; 2008 – **515.60** kWh/muaj. Pas vendosjes së njehsorit të ri (09.06.2007) konsumi mesatar mujor i konsumatorit është zvogëluar; 12 muaj para vendosjes së njehsorit të ri konsumi mesatar mujor ka qenë **332.33** kWh/muaj (regjistruar në njehsorin e vjetër), kurse 12 muaj pas vendosjes së njehsorit të ri konsumi mesatar mujor ka qenë **578.00** kWh/muaj (regjistruar në njehsorin e ri).
Provë: Listat e rrjedhjes së energjisë aktive
- ✓ Komisioni i KEK-ut në rekomandimin e tyre për faturim të rikthimit të humbjeve nuk ka bërë asnjë analizë të lëndës së konsumatorit, por vetëm ka shënuar procesverbalet e KEK-ut dhe kanë nënshkruar rekomandimin.
Provë: Rekomandimi i komisionit të KEK-ut për faturim të rikthimit të humbjeve
- ✓ Në procesverbalet e KEK-ut nr. 0145135 të datës 24.07.2008, nr. 177946 të datës 23.08.2008, nr. 182365 të datës 23.09.2008, nr. 233865 të datës 17.11.2008 vërehet se punëtorët e KEK-ut nuk kanë evidentuar numrin e vulës (bllombës) distributive, dhe këtë e kanë lënë nën arsyetimin se njehsori elektrik nuk ka mundësi të vulozet (bllombohet) pasi nuk ka kapak distributiv.
Provë: Procesverbalet e KEK-ut . 0145135 të datës 24.07.2008, nr. 177946 të datës 23.08.2008, nr. 182365 të datës 23.09.2008, nr. 233865 të datës 17.11.2008
- ✓ Me datë 25.06.2003 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik dhe se kanë hequr njehsorin nr. 179146 dhe kanë vendosur njehsorin nr. 34550450 dhe se ka vulosur dhe pranuar teknikisht njehsorin elektrik.
- ✓ Sipas analizave të bëra të rrjedhjes së energjisë aktive prej kohës kur është regjistruar ky njehsor (25.06.2003), e deri tek largimi i tij nga ekipi i KEK-ut (25.06.2007), shpenzimi i

energjisë elektrike i konsumatorit është mjaft i njëtrajtshtëm, nuk ka ndonjë moment ku mund të vërehet dyshimi i KEK-ut se numrat në numërues janë kthyer mbrapa.

Provë: Rrjedhja e energjisë aktive

- ✓ KEK-u nuk ka bërë analiza të rrjedhjes së energjisë aktive por konsumatorin e ka ngarkuar për shfrytëzim të paautorizuar vetëm duke u bazuar në konstatimet teknike të procesit të kalibrimit.
- ✓ Sipas deklaratës së konsumatorit theksohet se nga data 25.06.2003 me kërkesën e konsumatorit ekipi i KEK-ut ka marrë njehsorin nr. 179146 për bazhdarim dhe se pas shqyrtimit të njehsorit, ai ka rezultuar i pasaktë në matje. Ekipi i KEK-ut ka vendosur njehsorin nr. 34550540 dhe ka pranuar teknikisht njehsorin. Prej asaj kohe punëtorët e KEK-ut kanë bërë rregullisht leximin e njehsorit elektrik. Lokali është me hapësirë prej 19 m², hapësira ku gjenden njehsorët është e pambrojtur dhe se kush do mundet me pas çasje në njehsor elektrik. Nuk po kontestoj se në çfarë gjendje ka qenë njehsori me rastin e ndërrimit të tij, por kontestoj konstatimin se e kam manipuluar njehsorin. Punëtorët e KE-ut asnjëherë nuk kanë pasur vërejtje në njehsorin elektrik.

Provë: Deklarata e konsumatorit

DMK duke u bazuar në analizat e cekura më lartë, ka rekomanduar Bordin e ZRRE-së që të pranohet ankesën e konsumatorit dhe të vjen në përfundim se:

1. KEK-u duhet ta shkarkojë konsumatorin nga ngarkesa e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike fatura DPR08HP07129 në vlerë prej 8,357.83 €, të datës 12.12.2008.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet dhe argumentet e paraqitura dhe pas analizës së lëndës së konsumatorit ka vendosur që ta **pranojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. Të shkarkojë konsumatorin nga ngarkesa e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike fatura DPR08HP07129 në vlerë prej 8,357.83 €, të datës 12.12.2008.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar